

PANI I MALIT TË MILETIT-PANI I KAONISË. LEGJENDA, HYEU I PANIT, KULTI I PANIT. ALBANI/PANI-I KATËRTI I BREZIT TË PELLAZGUT

Kostaq PAPA
Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Pas zbulimit të figurinës prej bronzi të Panit në malin e Miletit në Butrint nga historiani dhe arkeologu H. Shabani, ai dhe arkeologët që studiuuan vendbanimet antike të Butrintit dhe Kaonisë, ju vendosën në një punë intensive për një studim të plotë të jetës parahistorike në Mile dhe përmbledhja e përshkrimeve të autorëve nga lashtësia e deri në ditët e sotme, të huaj e shqiptarë, për Panin e Madh. U mbledh material i bollshëm arkeologjik dhe dokumentacion historik me të dhëna dhe përshkrime, mes tyre edhe Legjenda e Panit të Madh. Legjenda e ruajtur në fshatrat autoktone pranë Milese na sjell Panin, perëndinë pellazgo-ilire si mbrojtës të jetës, të barinjve, barinjve dhe barinjve, i cili u preferua nga populli si profet mrekullish, shërues sëmundjesh, si shpikës i baritores, flaut si dashamirës i muzikës. Si simbol i qytetërimit pellazg, i Miletit dhe i Paganizmit Ilir, Pani i Madh është i kudondodhur, si gjysmë dhi, në festimet festive në Mile, Butrint, Çuka e Ajtoit, Buf, Diapor, Kestrinë. Vdekja e tij lajmëron fundin të paganizmit dhe ardhjes së krishterimit. Rikthimi i traditës së festimit të festave pagane në Qarkun e Butrintit dhe ish-Kaonisë është një sfidë me interes për kulturën, historinë, identitetin, turizmin dhe ekonominë.

Fjalë kyçe: pellazg, Kaonia, Butrint, Mali i Miletit, fyelli baritor, legjenda, traditë pagane, autorët, turizëm.

ABSTRACT

After the discovery of the bronze figurine of Pan on Mount Miletus on Butrint by the historian and archaeologist H. Shabani, he and the archaeologists who studied the ancient settlements of Butrint and Kaonia, put you to intensive work for a complete study of prehistoric life in Mile and the collection of descriptions of authors from antiquity to the present day, foreign and Albanian, for the Great Pan. Abundant archaeological material and historical documentation were collected with data and descriptions, among them the Legend of the Great Pan. The legend preserved in the autochthonous villages near Milese brings us Pan, the Pelasgian-Illyrian god as protector of life, shepherds, shepherds and herdsmen, who was preferred by the people as a prophet of miracles, healer of diseases, as inventor of the pastoral flute as a music lover. As a symbol of Pelasgian civilization, Miletus and Illyrian Paganism, the Great Pan is ubiquitous, like a half-goat, in the festive celebrations in Mile, Butrint, Çuka e Ajtoit, Buf, Diapor, Kestrine. His death heralds the end of Paganism and the Advent of Christianity. The return of the tradition of celebrating pagan holidays in the Butrint Region and the former Kaonia is a challenge of interest for culture, history, identity, tourism and economy.

Key words: Pelasgian, Kaonia, Butrint, Miletus Mountain, pastoral flute, legend, pagan tradition, authors, tourism.

1. Hyeu i Panit dhe rreth tij, kulti i Panit

Prania e Panit në hapësirën shqiptare ka shumë dekada që është dëshmuar, sepse në hapësirën pellazgo-pagane dëshmitë për Hyeun e Panit, Kultin e Panit ose thjeshtë Panin, janë shumë më të hërshme e nëpër shekuj. Po ashtu në gjithë Gadishullin Ilirik gjer poshtë në Attikë, në More e në Tebë (hapesira që përfshihen në Greqinë e sotme) është hasur Kulti I Panit. Kulti I Panit është futur në Athinë (Attikë) pas Betejës së Maratonës për kujtim të tmerrit e panikut që u kishte kallur ai persianëve. Adhurohej si Perëndi e pllenimit në periudhën klasike, shekujt VI-IV p.e.s, adhurohej në gjithë gadishullin tonë. Romakët e identifikonin

Panin me një perëndi të tyren, Fannus. Pani i Madh - emri i tij lidhet me legjenda të shumta si mjek e shërues sëmundjesh, si profet por dhe si shpikës i fyellit baritor. I pari që ka shkruar për Panin është Plutarku. Dhe Virgjili ka shkruar për Panin e Madh tek vepra “Eneida”. Si përfaqësues I Ilirisë, Hyeu i Panit figuron në Harkun e Trajanit në Benevento të Italisë. Hyeun e Panit apo Kultin e Panit e kanë përmendur shumë autor sidomos ata autor që janë marr me studimin e Pellazgëve, me periudhën e paganizmit, me qytetërimin miletas, me Ilirikun. Flasin për Panin e Madh vepra të autorëve të huaj të shekujve 18, 19, e 20. Autorët shqiptarë sidomos disa arkeologë e përshkruajnë Panin pas gjetjes së figurinës prej bronxi të Panit në malin e Miletit, pranë Butrintit, ku shquhet Pani I Kaonisë gjysëm njeri e gjysëm cjap.

2. Autorët e huaj dhe ata shqiptar për Hyeun e Panit.

Autorët e huaj. Konstatuam më sipër në hyrje se I pari që ka shkruar për Panin ishte Plutarku. Sipas Plutarkut, Pani vdiq kohën e Perandorit Tiber. Po sipas Plutarkut dhe priftërinjve të krishterë, vdekja e Panit paralajmëron fundin e Paganizmit dhe ardhjen e Krishtërit. Ka shkruar Virgjili për Panin e Madh tek vepra “Eneida” ku lajmëron se “Vdiq Pani I Madh!” anija që vinte nga Deti Ynë/Jon pranë Butrintit dha këtë lajm ogurzi. Anija përhap lajnin në ishujt dhe brigjet përreth për vdekjen e Panit të Madh në malin pranë qytetit të Butrintit. Luis Beonlew, autor francez i shekullit të 19 ka shkruar në veprën e tij “Greqia përpara grekëve”. Studjuesi nga Preveza i shkollës greke Niko Stylo me orgjinë shqiptare që jeton në Gjermani ka shkruar për Panin në disa vepra por është ndalur më shumë në veprën “Etruskishte Toskërishte”. Për rëndësinë që paraqet do e analizojmë në një paragraf më vete.

3. Autorët shqiptarë

Dhimitër Shuteriqi. Në veprën e tij me tregime të botuar në vitin 1960 e që është përfshirë në veprën letrare nr.7 në dy tregime jep të dhëna për Panin nga Kaonia sidomos në tregimin “Pani i vërtetë”, ku pasqyron dhe aspekte nga legjenda. Ramadan Sokoli, etnomuzikologu i shquar shqiptar e përshkruan Panin si mbrojtësin e kopeve, kullotave e barinjve dhe të dhënë pas muzikës. Vjen nga legjenda Pani i Madh duke bredhur livadheve me një bryll në dorë duke i fryrë dhe lëshuar tinguj nëpër pyje, ose duke i rënë fyellit nëpër livadhe e lëndina tek kullot bagëtia. E kanë përshkruar Panin disa arkeolog. Neritan Ceka e përshkruan Panin në “gjendje të përcudnuar dhe gaztor dasmash”. Arkeologu Skënder Anamali ka gjetur në qytetin antik “Amantia” një pjesë të figurinës së Panit në punim prej guri dhe e përshkruan si Hyeu i blegtorisë e bujqësisë. Arkeologu Selim Islami ka studjuar qytetin e Cukës së Ajtoit pranë malit të Miletit ku u gjet figurina e plot në bronx e Hyeut të Panit. Referuar kësaj figurine ai e cilëson si Hyeun e Paganizmit Ilir I kulteve të blegtorisë dhe bujqësisë. Arkeologu, historiani, studjuesi dhe shkrimtari Halil Shabani ka një pozicion të favorshëm në lidhje me historinë e Panit të Milesë sepse ai është zbuluesi I Panit të malit të Miletit. H. Shabani e cilëson Panin e Milesë si “hyeu i pjellorisë, blegtorisë e bujqësisë”. E quan Hyeu i Paganizmit Ilir, gjysëm kafshë (këmbë cjapi) dhe gjysëm njeri (nga mesi e lart). H. Shabani e përshkruan Hyeun e Panit të Milesë dhe në romanin “Arkondi I fundit I Butrintit, po ashtu dhe në “Guidën Konispoli”.

Si arkeolog e historian nga kjo trevë H. Shabani ka shkelur cdo cep të territorit e ka grumbulluar material të shumtë edhe për qytetërimin Miletas, Shpellën e Kreshmoit (Konispol) dhe Shpellën e Jetës (Shën Mërisë) në malin e Miletit. Studjuesi e etnologu Kostaq Papa e ka trajtuar Hyeun e Panit në disa shkrime. Ndërsa në veprën “Historia e Vendlindjes, Sopikut të Toskërisë, Arbërisë dhe Epirit” I ka kushtuar një kapitull Panit të Milesë. Ndërsa gjithë kërkimet që kanë lidhje me qytetërimin Miletas dhe Panin e Milesë dhe se si autorët e përshkruajnë Perëndinë Pellazgo-Ilire, pagane i ka grumbulluar në veprën Pani i Milesë dhe Kaonisë. Kanë qarkulluar të printuara në pak kopje por do jepen në qarkullim të plot për lexuesin. Për Panin kanë shkruar dhe autorë të tjerë. Material e figura për Panin e Madh të Milesë gjejmë në stendat e

Muzeut Arkeologjik të Kaonisë në qytetin e Sarandës, gjejmë në Muzeun e Qytetit Antik të Butrintit; gjer në vitin 1990 gjenim dhe në Muzeun Etnografik të Sopikut të Sarandës në stendën -Njeriu I lashtë I Milesë.

4. Niko Stylo për ALBANIN/PANIN—I Katërti I Brezit të Pellazgut

Niko Stylos ose Niko Stylo është nga autorët bashkëkohorë më ngulmues në studimet që kanë lidhje me truallin pellazgoilir-epiriot-shqiptar dhe nga autorët më prodhimtarë e studjuesit më të palodhur. Meqë mësimet shkollore i ka kryer në gjuhën greke, veprat e tij me studime për të qënë më i saktë në shprehje i shkruan greqisht, por është zotëruar i shqipes që e ka gjuhë të nënës, i lindur në Ftinë të Prevezës është më shqiptar se ne që kemi lindur në shtetin shqiptar. Niko Stylo ka bërë kërkime e studime për qytetimin miletas pellazguik, për Hyeun e Panit, Kultin e Panit, Panin e Kaonisë Panin e malit të Miletit. Në veprën “Etruskishte Toskërishte”. N. Stylo ndalet dhe analizon breznitë e Pellazgut. Niko Stylo duke hulumtuar Herodotin gjen se tek Helenet e lashtë hyjnitë më të reja janë Herkuli, Dionisi dhe Pani. Në Egjipt Pani është më i lashti, e nga tetë hyjnitë-e para; Herkuli i pari nga të dytët dhe Dionisi i pari nga të tretët. Egjiptianët e pasqyrojnë Panin fytyrë cjapi e këmbë cjapi. Në bashkëkuptim Pani dhe cjapi quhen mendis, pra mend, mencuri në gjuhën Arvanite shqipe që ka si sinonim apo emra të ngjashëm etrusk, tosk apo epiriot. Këtë lidhje e tregon emërtimi i Krahinës Italiane fillimisht Etruri e më pas Toskanë.

Sipaas trajtimit të N. Stylos, të Katërtin e Brezit të Pellazgut e gjejmë me emrin Alpan/Alban por dhe thjeshtë Pani. Koka e cjamin me brirë që është dhe në kokën e Panit gjendet dhe në përkrenaren e Gjergj Kastriotit edhe në shtatioren e Panit me bashkshorten e tij Afërditën. Albani apo Pani ishte i Katërti i Brezit të Pellazgut prej nga rrjedh i biri i brezit të pestë - Ari, (ndryshe Oineu ose Heleni). Prej Arit rrjedh biri i brezit të gjashtë Shqipia (ndryshe Pari apo Aleksandri, në turqisht Iskanderi) ndryshe Aetos. Helenet përveç se e quajnë Alvano/Alban dhe Pan e quajnë dhe Pandhion velaadhënës/shpikës i velave. Ky shpikës, hye i madh i detit prej tyre është quajtur Poseidon. Por ka dhe variante të tjera të shprehur nga autorët e lashtë, variant që Pani shihet si fëmijë jashtë martesë të Tiros, të cilin e birësoi dhe rriti Ari. N. Stylo i referohet shumë autorëve të lashtë tek skedon Breznitë e Pellazgut duke ndjekur renditjen dhe Albani apo Pani është i Katërti i Brezit të Pellazgut. N. Stylo i referohet Homerit dhe nxjerr nga hulumtimi konkluzionet e veta si rrjedhim logjik e shqipërim të thellë të fjalëve gjatë evolimit në kohë.

5. Qytetërimi Miletas dhe Pani i malit të Miletit mbi Butrint

Qytetërimi miletas është qytetërimi i lashtë pellazguik që ka shtryrje të madhe në brigjet mesdhetare me disa vendbanime miletase në Azinë e Vogël por dhe në atë që e quajmë Greqia e sotme, por skaji më i lart drejt Europës në qytetërimin miletas është në malin e Miletit, rreth 3-4 km larg Butrintit. Në malin e Miletit ka gjurmë jete mbi 8000 vjecare, në Shpellën e Jetes (Shën Mërisë), në brezin mbi Grykën e Bogazit dhe në shpella të tjera në mal (Pykë, Melisone, Palambar etj), në Muret e Vjetër Mbrojtës në Fortesën në shpatin lindor të malit që bënë pjesë në sistemin mbrojtës të Butrintit, në vendbanimet e vjetra etj. Në malin e Miletit apo Milesë si i thot populli, dhe qytetërimi miletas në këtë trevë përfshihen në hapësirën kaone. Gjetjet arkeologjike janë të shumta por dhe rrenojat e gjurmët e shumë objekteve ku është zhvilluar jeta e paraardhësve tanë të lashtë. Variant i parë por dhe më kryesori që ky mal emërtohet mali i Miletit është nga qytetërimi miletas që ka ekzistuar në të. Mali i Miletit është i mbushur me shumë breza shkëmbvorë, shpate të thepisura, shumë shpella, shquhet për kullotat më të mira dimërore në Shqipëri, shkurre e bimësi pyjore që rriten deri në majën 825m të malit, ku sot janë vendosur antenat televizive, të telefonisë dhe komunikimit satelitor. Pyjeve dhe kullotave, livadheve të malit të Miletit shfaqesh papritur, në lashtësi Pani i Madh, gjysëm njeri, gjysëm cjan me një bryll të cilën duke e vendosur në gojë nxirrte tinguj, po ashtu dhe prej fyellit, melodi që shoqëronin kopetë e bagëtive. Në vitin 1981 studjuesi Halil Shabani gjatë një ekspedite

në malin e Miletit, zbuloi figurinën prej bronxi të Panit të Madh, hyeun e paganizmit ilir, gjysëm kafsh (këmbë cjan) dhe gjysëm njeri (nga mesi e lart). Figurina e gjetur është një pasqyrim i qartë i Hyeut të Panit, hyeun pagan ilir që popullasta përreth e ka quajtur Pani i Madh por dhe Pani i Kaonisë, Perëndia e Panit të Madh, Pani Perëndi, Njeriu i Vjetër i Milesë, mbrojtës i jetës, barinjve, kopeve me bagëti, blegtorisë e bujqësisë, hyeu i pjellorisë, profet, shpikës i fyellit baritor, shërues i plagëve. Lajmi ogurzi që u dha nga Anija afër Butrintit për vdekjen e Panit të Madh, paralajmëroi fundin e paganizmit dhe fillimin e periudhës së Krishtërimin. Nga të gjitha figurinat e zbuluara deri tani në Shqipëri por dhe në territorët që sot i përkasin Greqisë, Pani i Milesë është figurina më e plot e derdhit në Bronx. Mali i Miletit është mali kryesor i Trevës së Butrintit dhe shtrihet në pjesën lindore të saj. Këmbët perndimore të malit fillojnë 3 km larg qytetit antic të Butrintit. Lartësia e malit arrin 825 m mbi nivelin e detit. Mali është i zgjatur nga veri perndimi drejt juglindjes rreth 10 km, ndërsa gjerësia lindje perndim varion në këmbët e tij 5-6km, faqja apo këmbët jugore janë të cregullt e më e gjatë rreth 6 km nga Vila në Malathre, ndërsa faqja veriore i ngjet një trapezi me përmasa 3.5km baza e poshtme, 2km brinjët anësore dhe rreth 200m në veri e 1 km në jug faqja e sipërme. Nga ana lindore faqja është e thatë vec disa krojeve në fund të këmbëve, ndërsa nga ana perndimore këmbët e malit lagen nga shumë liqene, pjesërisht të ëmbëla e pjesërisht të armirta/të kripura që quhen liqenet e Bufit, Armiroit, Xarres, Kalivoit dhe sfondin kryesor të ujit e zë liqeni i Butrintit me brigjet e Diaporit, me kanalën e Vivarit nga ku përmes baticë-zbaticës, hyn uji i kripur i Detit Jon ndaj uji i Butrintit është i kripur dhe me përmbajtje të lart squfuri.

5. Legjenda e panit të madh të milesë - Pani i Kaonisë

Në malin e Milërit mbi Butrint në vjeshtë, dimër e pranverë bari i kullotës dhe livadheve hasdiset nga klima e përshtatshme e bëhet kullota më e mirë në Shqipëri, Toskëri ose Epir ose Kaoninë e dikurshme. Mali i vendlindjes time dhe pse të krijon përshtypjen e një mali shkëmbvor, vec kullotave dimërore të cilësisë së lartë, edhe pyjet e valanidhit, lisit, dushkut mbulojnë borigat e shpatet në lartësinë mbi 400 m e thuajse krejt shpatet perndimore, gjë që shton praninë e shumë kafshëve të egra. Shpatet lindore e jugore të malit, dielli i kapo sapo del mbi Jugën e bardhë dhe menjëherë ndjehet zhurma e lëvizjes së kopeve nga stanet drejt kullotave. Zë të dëgjohet zhurma dhe tringëllimi i zileve dhe këmborëve. Vrapojnë Dëshët e Cjepët që prijnë bagëtinë duke përkundur në qafat e tyre zile, këmborë e cokane që përhapin lloj-lloj tingujsh e melodish si një orkestër në natyrë. Papritur shfaqet dhe një fyell baritor me muzikalitet apo dhe kumbimi i bryllave nga brirë bagëtish ose guaska moluskësh e kërmijsh gjigant. Dhe dëgjohet e përhapet melodia e fyellit si një vijë melodike, si dirigjim në një orkestër në këtë rast shumatorja e zileve dhe këmborëve; shfaqet fyelli baritor si solisti në një orkestër. Është fyelli baritor i Panit të Madh tek ecën pyjeve dhe kullotave të malit. Herë-herë përdor bryllën e madhe prej bri kau dhe fton bagëtinë në kullota e livadhe. Fton dhe barinj të ta shoqërojnë në melodinë e tyre me fyell.

Pani në moshë të re është energjik e këmbëshpejt duke qënë dhe këmbëcjan përshkon shpejt shpatet e malit, lëndinat, pyjet, përrenjtë dhe borigat. E njohin bagëtia dhe barinj të, shpendët dhe kafshët e pyllit dhe vrapojnë ta shoqërojnë nëpër faqet e malit me meloditë, blegërimat, hungërimat dhe cicërimat e tyre. Pani kjo krijesë e cuditshme njerëzore (e shtazore) që njihet nga gjithshka përreth, zgjon e frymëzon jetën e gjallë nëpër mal. Thuhet se ai nuk i ka ndalur asnjëherë meloditë e përditshme me brylla e fyej, qysh kur ishte fare i ri, qysh kur ra në dashuri me një vash në Kaoni. i dashuruar pas një princeshe kaone, që ishte e bukur si një zanë mali apo si një sirenë deti, liqeni; kumbonte malin me meloditë e tij. Por nuk qe e thënë që princesha e bukur si zanë mali e sirenë uji, të lejohej nga familja ti përgjigjej ndjenjave të dashurisë së tij. Pamja e tij e ashpër e konsideruar si jo e bukur por e shëmtuar e stepte ndjenjën, dashurinë dhe pëlqimin e familjes së vajzës kaone për të pranuar Panin dhe pse ishte i njohur nga barinj të dhe banorët por që ishte

gjysëm njeri e gjysëm cjac. Zhgënjimi në dashuri e shndëroi Panin e Madh në një qenie të mbyllur në vetvete, që ngushëllim gjente vetëm tek fyelli dhe meloditë që sajonte me të. Zhgënjimi me zanën e malit apo sirenen e ujit nuk ishte rasti i parë që kishte ndodhur me banorët e vendbanimeve afër brigjeve të liqeneve të Bufit, Armiroit, Xarrës, Kalivoit, Diaporit e Butrintit. Ishte zhgënjyer dhe herë tjetër me banorët e fushës. Zhgënjim pati njëherë dhe në Kestrinë. Shkoi të lahej në brigjet e lumit aty ku derdhet në Detin Tonë dhe kestrinasit e shihnin me përcimim për karakteristikat e pamjes së tij dhe pse barinjte dhe ata që e kishin njohur Panin e kishin përhapur lajmin se Pani i Madh i Milesë është zemërbutë, shpirtëmirë, shërues sëmundjesh përmes përdorimit të balsamëve me gjethe bimësh të egra; se ai nuk është i keq edhe pse në pamje duket i vrazhdë e i ashpër. Banorët që e takonin përditë, por dhe shumë nga banorët e malit-Miletasit, banorëve të vendbanimeve përreth malit e liqeneve në biseda që bënin kur takoheshin me ta, për Panin e Madh, i jepnin Panit të Milesë herë-herë jo vetëm përmasat e doktorit, shëruesit të sëmundjeve dhe epidemive por dhe përmasa profeti e filozofi. Pani u fliste barinjve dhe banorëve miletas me shembuj praktikë nga jeta dhe ata provonin e kështu shëroheshin nga sëmundje ose shpëtonin kopetë e tyre. Kështu ka ndodhur në shumë raste. Dhe Pani merrte përmasat e shpëtimtarit, mbrojtësit të barinjve, bagëtime, kullotave, pyjeve e livadheve.

Barinjte atij ja dedikonin kullotën e mirë e bagëtinë e shëndetshme. “E kemi nga Pani i Madh, ai është mbrojtësi ynë: thoshin. Dhe vërtetë deri në ditët tona vlerësimet kanë sjell etiketimin e kullotave të malit të Miletit si kullotat më të mira dimërore të Toskërisë, Epirit e krejt Shqipërisë. Pani i Madh i Milesë zbriste herë herë dhe në qytetin e Butrintit i mbushur me fyej e brylla hedhur krahëve për të dëfryer njerëzit dhe me tufa bimësh si ilace për të kuruar sëmundje. Sidomos në festat e mëdha pagane që bëheshin me kremtime e ceremoni në Butrint, Pani i Kaonisë (e tërrisnin dhe kështu) ishte i kërkuar nga banorët e trevës, si një profet e cudibërës. Dhe vet Pani i Madh ishte një dëfryes në këto kremtime e qëndronte krejt serioz kur priftëreshat realizonin ceremonitë, të mbuluara me kurora dafinash, palmash e gjithfarë lulësh e frutash nga pyjet e magjikshme të trevës. Pas disa ditë kremtimesh sepse festat në Butrint zgjatnin si ceremoni edhe një javë por dhe më shumë, kur kthehej për në shpellën e tij në Mile, ndjehej i vetmuar e që rrugës së kthimit shprehte zemërimin e tij përmes melodive vajtonjëse e ngashëruese. Nga zhgënjimi e zemërimi herë-herë i erreshin sytë dhe me britma dhe ushtimën e bryllave rendte nëpër pyll e boriga sa i hante vrapi e sa ti dilte zemërimi. Thuhet se hera-herës dhe kokës i binte nëpër shkëmbinj në momentet e zemërimit. Pani i Milesë zbriste për peshkim gjer poshtë tek liqenet e Bufit, Armiroit, Xarrës, Kalivoit, në Diapor e Butrint. Dhe peshkun që kapte një pjesë e hante aty, buzë ujit dhe e piqte. Pjesën e mbetur, të varrur krahëve bashkë me bryllat e sillte në mal. Dhe gjithmon kapte peshk të bollshëm. Thuhet që në një nga zbritjet e tij për peshkim tek ujrat e liqeneve të shumtë në këmbët perndimore të malit ai kishte parë vajzën e bukur, princeshën kaone për të cilën ndjeu dashuri. Dashuri që nuk u realizua por që i solli zhgënjim. Thuhet se ai, ka dashuruar dhe një vajzë Thesprote nga fiset më në jug të Kaonisë, kur ka udhëtuar disa herë jashtë viseve të Kaonisë, shumë më poshtë Cukës së Ajtoit, qytetit në jug të malit të tij ku shkonte nëpër festa e ceremoni pagane. Vajzën Thesprote thonë që e kishte parë disa ditë larg pasi kishte kaluar lumin e Thesprotisë.

Ka variante dhe legjenda që thonë se Pani i Kaonisë ka udhëtuar edhe deri poshtë në More, ku aty ka rënë në dashuri me një vajzë të bukur princeshë nga Morea e që u përpoq ta mirrte me vete gjatë kthimit në Kaoni. Por që familjarët e saj nuk e lanë që ajo ti përgjigjej ndjenjave të Panit, apo dhe më keq të shkonte me të në viset larg, aty lart në Kaoni. Se sa e mundshme ishte që Pani i Madh i Kaonisë të ket arbritur deri në More këtë asksh nuk na e thot e as nëpër burimet që shfletojmë nuk gjejmë gjë. Por që Kultit i Panit ka shtrirje jo vetën në Kaoni, e jo vetëm Pani i Milesë, por Kultit i Panit ka ekzistuar në Attikë, More e Tebë. Një nga variantet e legjendës Pani Perëndi e jep të martuar me Perëndeshën Afërditë e në veprën e N. Stylos gjejmë

foton e skulpturës të Panit me Afërditën, biles Pani ka në kokë simbolin që shekuj më vonë e gjejmë në përkrenaren e Gjergj Kastriotit. Legjenda e Panit të Milesë ka përshkrime nga lëvizjet e Panit nëpër mjediset kryesore të Trevës së Butrintit, sidomos në ato mjedise që sot ruajnë vlera kulturore, historike, arkeologjike, natyrore e turistike. Pani është i kudondodhur në shpatet e malit të Miletit; ato ishin hapësirat kryesore jetësore të tij, nga Muret e Lashta dhe Shpella e Jetës (Shën Mërisë) mbi Grykën e Bogazit në jug e deri në burimin e Soronesë në veri të malit. Por Pani i ka gjesdisur territoret në lumin Pavël, burimet në këmbët lindore të malit, në Kostël, Rëzë, Dobër, Vilë, në vendbanimet në very, Sopik, Shulglat, në fushën e Sheshit të Rahut; në liqenet e Bufit, Xarres, Armiroit, Kalivoit e Butrintit. Është gjendur Pani edhe në festimet në Cukën e Ajtoit e Malathre e sigurisht dhe në hapësirat më afër në Xarrë e pak më tej në Kestrinë. Por zbritjen kryesore e bënte kur shkonte për kremtimet në Butrint. Dhe i ka dëfryer banorët e trevës me meloditë e tij me fyell e bryll, dhe është kthyer në shpellën e tij duke u ndjerë mirë, por herë-herë dhe i mërziur e i zhgënjyer, i vetmuar e i braktisur. Dhe pse mënyrë jetese Pani kishte të jetuarit i vetmuar, ai çdo ditë të jetës së tij ishte pranë kopeve, pranë barinjve, pyjeve e kullotave. Sa herë që barinjve u ndodhte dicka me bagëtinë ata vraponin të gjenin Panin dhe ai i papërtuar bënte gjithshka për të shpëtuar kopenë. Pani e fitoi me mënyrën e tij etiketimin si mbrojtës i jetës, barinjve me bagëti të natyrë.

Gjatë gjithë jetës ai ishte i lidhur me mjedisin e tij jetësor në malin e Miletit e hapësirat përreth ku shkeli e vizitoi, ndejti e kremtoi caste të shënuara në ditë festimesh, në ditë peshkimi, në ditë të mira e të vështira. Pani nuk ju nda natyrës vec ditën që humbi e u shkri një me të, për tu bërë pjesë e përhershme dhe përjetësisë natyrore të Kaonisë dhe Trevës së Butrintit në vecanti. Vdekja e Panit ishte një ngjarje që nuk kaloi lehtë por që u pasqyrua në hapësirën e tij jetësore, tek barinjtë, te bagëtia, te njerëzia dhe kafshët e pyllit. Vdekja e Panit e shoqëroi jetën e banorëve jo vetëm në ditët që ndodhi e që u kryen ritualet, por dhe më vonë duke patur jehonë e përhapje të lajmit edhe tej Kaonisë sepse ai ishte një personazh i vecantë që erdhi deri në ditët tona me tipare të mitizuara, përmes legjendave, përmes pasqyrimit që njerëzia i ka bërë figurës së tij gjysëm njeri e gjysëm cjan, përmes pikturimit real e fantazisë së portretit të Panit, përmes figurinave e terakotave, skulpturave të ruajtura që janë gjetur e ndoshta do gjenden dhe të tjera.

Vdekja e Panit

O fuqi e mbinatyrshme, o perëndi, o natyrë, o mal, ka ndodhur një gjëmë, ka ndodhur një drithërimë e një britmë që del nga mali, pyjet, kullotat, shpellat, krojet, përrejtë, një ulërim, një hata. Nga thellësia e malit ngrihet një re dhe mjegull. Britma të mëdha, pastaj heshtje, pastaj ulërima kafshës e njerëzish. Pastaj heshtje varri. Dhe përsëri ulërima therësë. Po tundet mali po lëvizin pyjet, po zhurmojnë përrenjtë, po coroditen bagëtitë nëpër kullota. Kafshët e egra të pyllit s'gjejnë rehat e hidhen andej-këndej. Po mungon një britmë e njohur, mungon një kumbim zëri e melodie. Mungon e nuk dëgjohet më fyelli baritor i përditshëm, mungon brylla që mblidhte kafshët e pyllit dhe bagëtitë! Pse? Askush nuk e di. Askush nuk do që ta besoj. Mungon këtë ditë Pani. Mungon melodia e fyellit të tij. Mungojnë lëvizjet rendjet e tij nëpër pyje, mungon përshëndetja e tij me barinjtë dhe bagëtitë. Cjepët dhe Dëshët që prijnë kopenë e madhe të malit janë shtrirë përtokë e nuk duan të kullosin. Lajmi po përhapet me shpejtësi në të gjithë malin e Miletit, që nga Muret e Vjetra, Fortesa, Shpella e Jetës e deri te burimi i Soronesë; nga burimi i Kostlës në këmbën lindore të malit e gjer poshtë në Buf e Armirua në burimet e ëmbëla e të kripura tek liqenet në anën perndimore të malit. Vdiq Pani! Pani i Madh i Milesë! Pani i Kaonisë! Pani ishte simboli i një mali ku lulëzonte jetë njerëzish e kafshësh e ku luftrat qenë harruar. Vdiq Pani! Njerëzit venë e vinë tek kullota afër hyrjes së shpellës ku ka ndodhur gjëma e pabesueshme, ku pak caste më parë kishte dhënë shpirt Pani i Madh. Pamja e tij dhe pse e qetë dhe e fiksuar përgjithmon me sytë nga qielli, me gojën hapur e njerën nofull të zhvendosur, të krijonte ankth e stress dhe si një frikë të brendshme. Fyejtë e veglat e tjera muzikbërëse ishin shpërndarë përreth

trupit të Panit mbi lëkurët e kafshëve ku dergjej prej disa ditësh. Vdiq Pani i Madh i Milesë!

Zogjtë lajmëtarë e vajtues shpërndajnë lajmin nëpër pyje, përrrenj e boriga me shkëmbinj. Ulërimat ndihen gjer poshtë tek liqenet, në Buf e Armirua, në Kalivo e Diaporit. Lajmi i gjëmës ka arritur në Butrint. Nga qyteti është nisur e po del një turmë njerëzish, priftëreshash. Luftëtarësh e obortarësh. Vargu i kolonës po vjen drejt malit për tek shpella e Panit të Madh të Milesë. Vargu i kolonës po zgjatet e po shtohet edhe me njerëz nga fushat dhe me peshkatarë tek liqenet. Vdiq Pani i Milesë, i kudondodhuri në kremtimet festive të Trevës, personazhi i njohur nga të gjithë banorët. Edhe ata që nuk e kishin parë, kishin dëgjuar për të. Lajmi u përhap në gjithë trevën e nga të gjitha drejtimet po vijnë njerëz drejte vendit ku nuk lëviz më Pani i Madh. Po vijnë nga Kestrina, Kataitoi, Cuka e Ajtoit, Shpella e Kreshmoit, Malathrea, Vila, Dobra, nga kështjellat e Laskos e Bezhanit, nga Sopiku, kështjella e qytetit të rrethuar nga kopshtijet e kodrat; nga Rëza e Bakullati, e sigurisht nga Bufi, Xarra, Armiroi, Diapori, Kalivoi e Butrinti. Një anije doli nga Butrinti përmes Vivarit në det të hapur të shpërndaj lajmin në brigjet e Kaonisë dhe në brigjet e ishujve të Feakëve përballë. Anija çan ujrat e Detit Tonë dhe shpërndan lajmin e vdekjes së Panit. Anijet që kalojnë ndalin pak, njerëzit dëgjojnë lajmin: "Vdiq Pani i Madh! Perëndia jonë! i Madhi Ynë! Çudibërësi Ynë! Mbreti Ynë! Lavdiploti Ynë! Pagani Ynë. Anijet që kalojnë marrin e shpërndajnë lajmin në brigjet e Pellazgjisë, Ilirikut të mëvonshëm, në brigjet e Kaonisë e të Thesprotisë. Në Trevën e Butrintit pllakosi zi për disa ditë.

PËRFUNDIME

1. Hyeu i Panit apo Kulti i Panit është hasur në gjithë hapësirën e Gadishullit të Ilirikut, sidomos në trevat jugperndimore e jugore: në Kaoni/Toskëri/Epir, në Attikë, në Tebë, në More.
2. Në Attikë Kulti i Panit ka hyrë pas Betejës së Maratonës.
3. Pani adhurohej si Perëndi në gjithë Ilirikun si Perëndia Pan ose Pani i Madh. Është i njohur e Identifikuar nga Romaket dhe helenët, Pani dhe Kulti i tij.
4. Shumë legjenda janë thurrur për Panin e Madh/Hyeun e Panit/Kultin e Panit për Panin e Milesë që e shquajnë këtë personazh mitik të Ilirikut Pagan si një Perëndi Pagane, si profet por dhe si shërues sëmundjesh, shpikës i fyellit baritor e brylles; si mbrojtës të jetës, barinjve e bagëtive, si mbrojtës i blegtorisë dhe bujqësisë, si mbrojtës i livadheve/kullotave e pyjeve.
5. Shumë autor kanë shkruar për Kultin e Panit që nga lashtësia. Prezenca e Panit të Madh është e rëndësishme në hapësirën pellazgo-ilire-shqiptare.
6. Legjendat për Panin në hapësirën ilirike, shprehin fuqi të jashtzakonshme të traditës popullore e historike dhe kanë orgjinalitetin e tyre.
7. Legjenda e Panit të Milesë apo ndryshe Panit të Kaonisë është një legjendë e vecantë me ngarkesa epike dhe emocionale, me rëndësi për ritet dhe traditën në epilogun e periudhës pagane.
8. Rikujtimi, ikonizimi apo celebrimi/kremtimi përmes panairi në qytetin e Butrintit dhe hapësirën e trevës shoqëruar me kremtime të tjera pagane do të paraqiste rëndësi për turizmin në jug të vendit e do të rikthente traditën e kremtimeve madhështore pagane që kryheshin në lashtësi në trevë në tërësi e qytetin e Butrintit në vecanti.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. Plutarku për Panin.
2. Virgjili—vepra "Eneida".
3. Luis Beonleë—Greqia përpara grekëve. Tiranë 2008.
4. Niko Stylo—Etruskishte Toskërishte. Tiranë 2010

5. Niko Stylo—Hyrje në Albanologji/ Isagoji stin Albanologia. Në process botimi.
6. Dhimitër Shuteriqi—Pani I Kaonisë (dy tregime)vepra letrare nr 7, f 81-92, Tiranë 1982
7. Neritan Ceka—vepra ‘‘Ilirët’’; shkrime në media dhe intervista në Tv.
8. Skënder Anamali, arkeolog—Arkiva e Arkeologjisë.
9. Selim Islami arkeolog—Arkiva e Arkeologjisë.
10. Halil Shabani—Historian Arkeolog-zbuluesi I figurinës së Panit të Milesë.-Gazeta Bashkimi 1981
11. Halil Shabani-Arkondi I fundit I Butrintit-roman. Milosao, Sarandë 2008
12. Halil Shabani—Guidë :Konispoli.—Legjenda e Panit.f 17-18. Sarandë 2008.
13. Kostaq AT Papa—Historia e Vendlindjes, Sopikit të Toskërisë, Arbërisë dhe Epirit. Veper ne botim.
14. Kostaq AT Papa—Pani I Madh I Milesë—Pani I Kaonisë. Vepër proces botimi.
15. Kostaq AT Papa—Shkrime për Panin dhe Treven e Butrintit në mediat elektronike.
16. Muzeu I Kaonisë Sarandë—Materiale, stendë e figura për Hyeun e Panit.
17. Muzeu I Qytetit Antik I Butrintit-Stenda e figura të Panit.
18. Ish-muzeu Etnografik I fshatit Sopik-stenda: Njeriu I Lashtë I Milesë.